

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaCeram[®]-500 Ceralastic

LLAÇ ÇIMENTOJE PËR HIDROIZOLIM DHE KOLLË PLLAKASH 2 NË 1

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaCeram[®]-500 Ceralastic është kollë pllakash çimentoje, me 1 përbërës, e modifikuar me polimere, shumë e deformueshme, me rezistencë ndaj alkaleve dhe e përforcuar me fibra sintetike me veti llaçi hidroizolues dhe mbrojtjeje të betonit. Trashësi shtrese <5,0 mm. Përdorim në mjedis të brendshëm e të jashtëm. Kategoritë: EN 12004: C2 E S2. EN 14891: CM02P. EN 1504-2: PI-MC-IR. Produkti mund të përdoret gjithashtu edhe për fiksimin e paneleve izoluese në mjedis të brendshëm.

PËRDORIMET

Kollë pllakash për:

- Të gjitha llojet e pllakave qeramike, përfshirë grës porcelain me përmasa të mëdha
- Mermer dhe gurë të tjerë natyrorë
- Shtrim pllakash me sisteme ngrohjeje nën dysheme
- Shtrim pllakash të reja mbi pllaka ekzistuese në mjedis të brendshëm
- Performancë e lartë dhe aplikime kërkuese, si: pishina, fasada, ballkone dhe terraca
- Fiksimit të paneleve izoluese

Llaç hidroizolues përpara aplikimit të kollës dhe pllakave:

- Pishina, terraca, ballkone, banjo, dushe, përpara shtrimit të pllakave qeramike të shtruara me kollë
- Llaç për mbrojtje betoni në:
- Struktura ujëmbajtëse dhe kundër kripës për shkrirje akulli (klorure), dëmtim nga dioksidi i karbonit

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Kollë pllakash, llaç hidroizolues dhe mbrojtës për betonin, në 1 produkt të vetëm
- Produkt me 1 përbërës
- Për ngjitjen e pllakave të murit dhe dyshemesë
- Aplikim me: mallë, furçë, rul ose spërkatje
- Ndërkapje e mirë mbi të gjitha llojet e nënshtresave: çimentoje, pllaka qeramike, gur, tulla dhe dru, etj.
- Shumë e deformueshme
- Kohë e zgjatur punueshmërie
- Aftësi e mirë për ngushtim plasaritjesh
- Mbushje fugash pas 12-24 orësh
- Ngjitje me përhapje të një shtrese të vetme kolle
- Fiksimit pikësor i paneleve izoluese prej polistireni, shkume poliuretani dhe lesh qelqi
- Konsumim i ulët material në krahasim me sistemet tradicionale

MIRATIME / STANDARDE

Kollë pllakash

- Markë CE dhe Deklaratë Performance EN 12004 - Kollë pllakash

Hidroizolim

- Markë CE dhe Deklaratë Performance EN 14891 - Produkte të lëngshme të padepërtueshme nga uji për përdorim poshtë pllakave qeramike të ngjitura me kollë

Mbrojtje betoni

- Markë CE dhe Deklaratë Performance EN 1504-2 - Produkt - veshje për mbrojtjen e sipërfaqes së betonit

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Çimento, agregate të përzgjedhura, aditiv për mbajtje uji, polimere, fibra
Ambalazhi	Thes 20 kg
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur gri

Jetëgjatësia	9 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin original, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +35°C. Lexoni gjithmonë ambalazhin.
Përmasa maksimale e kokrrizës	D _{max} : 0,315 mm
Deklarata e produktit	EN 12004:C2 E S2. EN 14891: CM O2P. EN 1504-2: IP-MC-IR

TË DHËNA TEKNIKE

Përshkueshmëria e dioksidit të karbonit	SD ≥ 50 m	(EN 1062-6)	
Përshkueshmëria e avujve të ujit	S _D < 5 m (Kategoria I)	(EN ISO 7783:2012)	
Absorbueshmëria kapilare	< 0,1 kg/m ² h ^{0,5}	(EN 1062-3)	
Rezistenca ndaj ciklit ngrirje-shkrirje dhe kripërave akullshkrirëse	> 0,8 N/mm ²	(EN 13687-1)	
Papërshkueshmëria e ujit	Pa kalim uji (7 ditë në 1.5 bar)	(EN 14891 - A.7)	
Aftësia e ngushtimit të plasaritjeve	Kushtet	Ngushtim plasaritjesh	(EN 1062-7)
	Statike	> 0,5 mm (Kategoria A3)	(EN 1504-2)
	Dinamike, 1000 cikle	Pa plasaritje (Kategoria B2)	
	Kushtet	Ngushtim plasaritjesh	(EN 14891)
	Standarde (+23°C)	≥ 0,75 mm	
	Temperaturë e ulët (-5°C)	≥ 0,75 mm	
	Temperaturë e ulët (-20°C)	≥ 0,75 mm *	
	* Me rrjetë përforcuese		
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	Fillestare	≥ 1,5 N/mm ²	(EN 14891)
	Zhytje në ujë	≥ 1,0 N/mm ²	
	Vjetrim nga nxehtësia	≥ 1,0 N/mm ²	
	Ciklet ngrirje-shkrirje	≥ 1,0 N/mm ²	
	Zhytje në ujë gëlqereje	≥ 1,0 N/mm ²	
	Zhytje në ujë të kloruar	≥ 0,5 N/mm ²	
Shformimi tërthor	≥ 10 mm	(EN 12002)	

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	Kollë pllakash:	
	Për nënshtresat e mëposhtme duhet të përdoret prajmer:	
	Nënshtresa	Prajmer
	Gips, suva, llaç anhidriti	Sika® Primer-11 W
	Pllaka qeramike ekzistuese, fletë PVC-je, linoleum dhe dysHEME ekzistuese vinili	Sika® Primer-21 W
	Kollë pllakash	SikaCeram®-500 Ceralastic
	Shtresë hidroizoluese:	
	Shirit hidroizolues (fuga kontrolli dhe lëvizje të vogla)	SealTapes: B,S,F
	Shirit hidroizolues (lëvizje të mëdha)	sistemi Sikadur Combiflex® SG
	Llaç hidroizolues	SikaCeram®-500 Ceralastic

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	Aplikim mbi dysHEME	~4,8 litra për thes 20 kg (24 % ± 1 %)	
	Aplikim mbi mur	~4,0 litra për thes 20 kg (20 % ± 1 %)	
Dendësia e llaçit të freskët	~1,6 kg/l		
Konsumimi	Kollë pllakash Konsumimi varet nga nënshtresa, profili i sipërfaqes, ashpërsia dhe teknika e aplikimit. Si udhëzim për një shtresë kolle:		
	Përmasat e pllakave	Përmasat e mallës	Konsumimi
	E vogël	mallë krëhër 8 mm	~ 2,5 kg/m ²
	Mesatare	mallë krëhër 10 mm	~ 3 kg/m ²
	E madhe	mallë gjysëm hënë 15 mm	~ 6,5 kg/m ²
	Hidroizolim dhe mbrojtje betoni ~1,2 kg/m ² për mm trashësie. Këto vlera janë teorike dhe nuk përlogarisin asnjë material shtesë për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon, etj.		
Trashësia e shtresës	5,0 mm max.		
Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +30 °C max.		
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +30 °C max.		
Koha e maturimit	~3 min		
Koha e punueshmërisë	~40 min në 23 °C		
Koha e përpunimit	≥ 0,5 N/mm ² pas 30 min	(EN 1346)	
Koha e maturimit	3 orë në varësi të kushteve të mjedisit		
Metoda e maturimit	Të mbrohet nga kushtet e pafavorshme të motit, si temperaturat shumë të larta apo ngricat, shiu, ekspozimi i drejtpërdrejtë në diell, për të paktën 12–24 orë nga aplikimi.		
Produkti i aplikuar gati për përdorim	Përdorimi	Koha e pritjes	
	Qarkullim këmbësorësh	12 orë	
	Mbushje e fugave të pllakave në dysHEME	24 orë	
	Mbushje e fugave të pllakave në mure	3 orë	
	Qarkullim i plotë	48 orë	
	Zhytje në ujë	72 orë	

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Kollë pllakash, llaç hidroizolues dhe mbrotje për betonin

Nënshtresat prej çimentoje duhet të jenë maturuar dhe tharë mjaftueshëm (2-6 javë). Të gjitha nënshtresat duhet të kenë strukturë të qëndrueshme dhe të jenë të afta për të përballuar peshën e pllakave të reja që të ofrojnë një bazë të sigurtë. Sipërfaqet duhet të jenë të pastra, të thata dhe pa grimca të lira e të shkrifëta, kontaminues si pluhur, pislëqë, vaj, dyll, llak, graso, kore çimentoje (qumësht) ose efloreshencë.

Në varësi të kushteve të sipërfaqes dhe

kontaminuesve që duhet të hiqen nga sipërfaqja, përdorni teknika të mjaftueshme për përgatitjen e sipërfaqes për të hequr të gjitha gjurmët nga çdo material që mund të reduktojë lidhjen e produktit me nënshtresën. Sipërfaqet e lëmuara duhet të ashpërsohen lehtësisht për të përmirësuar ndërkapjen. Për të konfirmuar përgatitjen dhe ndërkapjen e mjaftueshme të nënshtresës, kryeni një testim të vogël përpara aplikimit të plotë. Çdo defekt i vogël mbi sipërfaqe dhe ndryshimet në nivel, profil ose agregatet e ekspozuara mund të mbushen paraprakisht dhe të nivelohen me një shtresë tjetër SikaCeram®-500 Ceralastic deri në trashësi max. 5 mm, të aplikuar të paktën 24 orë përpara aplikimit të plotë të kollës. Për zona më të mëdha dhe më të trasha për riprofilizim sipërfaqeje,

përdorni llaçet e duhur nga seria Sika MonoTop® ose Sikafloor® Level. Duhet të identifikohen plasaritjet mbi nënshtresë dhe të izolohen p.sh. me rrëshirat epokside Sikadur.

Për aplikime në klimë / mjedis të nxehtë, ose mbi nënshtresa absorbuese, lagni paraprkishtë të gjithë sipërfaqen menjëherë përpara aplikimit të produktit. Shmangni grumbullimin (pellgun) e ujit mbi sipërfaqe. Sipërfaqja nuk duhet të jetë e lagësht në prekje.

Kollë pllakash

Gjatë shtrimit të pllakave mbi nënshtresa joabsorbuese ose me absorbueshmëri të kufizuar, si pllakat ekzistuese qeramike, sipërfaqet e lyera, etj. kontrolloni për të konfirmuar nëse këto sipërfaqe janë të qëndrueshme, të ngjitura fortë dhe të sigurtat. Pastaj, përdorni produkte të përshtatshme për largimin e yndyrës / smërçit për të pastruar plotësisht sipërfaqen.

Për shtrim pllakash në dhoma gjithmonë të lagura ose me lagështi, atëherë duhet të aplikohet mbi nënshtresë një produkt / sistem i përshtatshëm hidroizolimi Sika® përpara shtrimit të pllakave.

PËRZIERJA

Hidhni sasinë e rekomanduar të ujit brenda një ene të pastër dhe të përshtatshme për përzierje.

Ndërsa jeni duke përzierë, shtoni ngadalë pluhurin SikaCeram®-500 Ceralastic tek uji dhe përzieri plotësisht me një mikser manual elektrik në shpejtësi të ulët (~500 rpm) derisa materiali të jetë përzierë plotësisht dhe të mos ketë kokrriza. Shmangni bllokimin e ajrit brenda miksit nga përzierja e tepruar. Lëreni produktin e përzierë të 'maturohet' për 2 – 3 minuta përpara përzierjes tjetër për 30 sekonda. Miksi përfundimtar duhet të ketë konsistencë kremoze, ngjyrë të njëtrajtshme dhe të përhapet dhe aplikohet me lehtësi.

APLIKIMI

Kollë pllakash

SikaCeram®-500 Ceralastic aplikohet me mallë krëhër. Aplikoni kollën mbi sipërfaqen e përgatitur me mallën e duhur dhe shtrojeni në trashësinë e kërkuar. Aplikoni mjaftueshëm kollë me mallën e duhur mbi sipërfaqen e përgatitur në trashësinë e kërkuar. Aplikoni mjaftueshëm produkt për të siguruar mbulimin e mjaftueshëm të pjesës së pasme të pllakave. Mbulimi i pjesës së pasme të pllakës duhet të jetë 100% për kushtet e lagura/ lagies nga uji dhe pllakat e dyshemeve.

Shtrimi i pllakave duhet bërë mbi kollën e freskët, duke ushtruar presion të mjaftueshëm për të siguruar kontaktin e plotë dhe të njëtrajtshëm me kollën dhe kështu ngjitjen optimale.

Nëse mbi sipërfaqen e kollës formohet një cipë, hiqeni menjëherë me mallë, hidhni materialin dhe aplikoni një shtresë të freskët kolle SikaCeram®-500 Ceralastic. Rregulloni pllakat nëse kërkohet.

Pastroni kollën e tepruar nga pjesa e sipërme e pllakës apo ndërmjet fugave përpara se adezivi të jetë tharë.

Pas kohës së kërkuar të pritjes aplikoni bojakun e duhur për mbushjen e fugave.

Referohuni tek skedat teknike të secilit produkt.

Hidroizolim dhe shtrim pllakash në 2 hapa

Shiritat hidroizolues duhet të aplikohen gjithmonë mbi fugat e kontrollit që janë subjekt i lëvizjeve të vogla dhe zonave të tjera kritike si cepat, qoshet, skajet ndërmjet materialeve me nënshtresë të ndryshme: Aplikoni shiritin vetëngjitës Sika® SealTape B mbi nënshtresën e përgatitur.

Aplikoni Sika® SealTape S ose Sika® SealTape F mbi një shtresë të freskët SikaCeram®-500 Ceralastic dhe mbuloni me një shtresë të dytë SikaCeram®-500 Ceralastic.

Referohuni tek skedat teknike të secilit produkt. Pasi të jenë vendosur shiritat izolues, lagni nënshtresën.

Aplikoni SikaCeram®-500 Ceralastic me një mallë të sheshtë, duke ngjeshur llaçin mbi nënshtresë në mënyrë që të sigurohet ndërkapja e duhur.

Trashësia totale e aplikimit duhet të jetë të paktën 3 mm në 2 shtresa prej max. 2 mm për të arritur një shtresë të njëtrajtshme, pa defekte dhe të vazhdueshme. Koha e pritjes midis 2 shtresave është ~3 orë.

Pas ~4 orësh aplikoni SikaCeram®-500 Ceralastic si kollë pllakash.

Hidroizolim dhe ngjitje pllakash në 1 hap me mallën e posaçme*

- Mbi dysheme, SikaCeram®-500 Ceralastic mund të aplikohet me një hap duke përdorur mallën e posaçme 'Ceralastic'.
 - Përzgjedhja e mallës SikaCeram®-500 Ceralastic 'Ceralastic' varet nga madhësia e pllakës për të siguruar mbulimin e plotë të pjesës së pasme të pllakës me produktin. Malla 'Ceralastic' 10 mm rekomandohet për pllaka me madhësi deri në 25x25 cm; për pllaka më të mëdha përdorni një mallë XX mm.
 - Gjilpërat e adaptueshme prej çeliku duhet të dalin jashtë gjatësisë së dhëmbit të mallës të paktën 3 mm. Shtresa hidroizoluese që rezulton poshtë shtresës së kollës së pllakave duhet të jetë min. 2 mm.
 - Lagni nënshtresën dhe aplikoni SikaCeram®-500 Ceralastic me mallën 'Ceralastic' pastaj shtroni direkt mbi llaçin e lagur.
 - Aplikoni mjaftueshëm produkt për të siguruar lagien e plotë të pjesës së pasme të pllakave.
 - Trashësia totale duhet të jetë midis 4 dhe 5 mm në një shtresë të njëtrajtshme dhe të vazhdueshme.
- * Nuk është i përshtatshëm për pishinat dhe aplikimet vertikale.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Nënshtrësat prej suvaje gipsi dhe llaç anhidriti duhet të kenë përmbajtje lagështie min. 0,5 %.
- Për pishinat dhe aplikimet vertikale përdorni SikaCeram®-500 Ceralastic në 2 hapa aplikimi. Produkti duhet të mbulohet gjithmonë me pllaka.
- Mos aplikoni llaçin hidroizolues dhe kollën e pllakave në një hap për aplikimet vertikale.
- Referohuni tek udhëzimet e prodhuesit të pllakave për krijimin e fugave të zgjerimit.
- Nëse priten temperatura shërbimi nën -20°C, përforconi SikaCeram®-500 Ceralastic me një rrjetë fibrash qelqi me rezistencë ndaj alkaleve.
- Të mos përdoret mbi mermer ose pllaka guri natyror nëse ato kanë ndjeshmëri ndaj ujit.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtrësat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
SikaCeram®-500 Ceralastic
Korrik 2019, Botimi 01.01
020404020010000322

SikaCeram-500Ceralastic-sq-AL-(07-2019)-1-1.pdf

